# DËSHMI ARKIVI

**A-450350**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Gjenerali i NATO-s reagon ndaj Hagës: Thaçi nuk është kriminel për t'u dënuar |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/denimi-i-ish-krereve-te-uk-se-gjenerali-i-nato-s-reagon-ndaj-hages-thaci--i104539` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 19:09:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 18:52:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | d48b94954738042583f93c99aaa1c7f12dc73bf7bed3cf5a88d64b5d8c9b64c4 |
| TEKSTI | 7b608b5618329904f00aac5e3fdfbf53fc7861adfdd031be000e1e5f035f6d6e |
| PAMJA | 1837c33634cf376e2a859ea69f45c8e70f7642d4bbf8074ee1c503b646076a88 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | c8181e1cd11290e086b815385a4929a8aa4151a2add4e9de98284a283e986ee9 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c8181e1cd11290e086b815385a4929a8aa4151a2add4e9de98284a283e986ee9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Gjenerali i NATO-s reagon ndaj Hagës: Thaçi nuk është kriminel për t'u dënuar

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 20:52



Ish-gjenerali i NATO-s, Wesley Clark deklaroi se ishte i shokuar dhe i zemëruar për vendimin e Gjykatës së Hagës, e cila dënoi me gjithsej 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së.

Ai tha se nuk ka parë asnjë dëshmi që të justifikojë këtë lloj vendimi. Sipas tij tani do të jetë një rrugë e vështirë për të ardhmen.

"Jam i shokuar dhe i zemëruar. Unë e njoh Thaçin dhe shokët e tij dhe të gjithë ata që kanë bërë luftën. Unë kam dëshmuar në gjyq kam thënë se çfarë kam parë dhe e dija se çfarë po ndodhte në Kosovë dhe bashkëpunimin tonë me UÇK-së dhe nuk kam parë asnjë dëshmi që të justifikojë këtë lloj vendimi. Fatkeqësisht Gjykata e dha vendimin e vet dhe kjo do të jetë një rrugë e vështirë në të ardhmen", u shpreh gjenerali Clark në Off the Record, në A2 CNN.

I pyetur nëse kishte diçka që përputhej mes asaj që thoshin gjyqtarët dhe asaj që gjenerali ka parë me sytë e tij, ai u përgjigj se Hashim Thaçi bëri një punë të shkëlqyer për të ruajtur edhe popullatën e pafajshme serbe.

"Me aq sa di, këto dëshmitë sekrete që edhe vetë nuk më treguan asnjë dëshmi nga prokuroria, nuk do të më bënin dhe që të ndryshonin mendimin tim. Unë jam takuar tre herë me Hashim Thaçin gjatë konfliktit dhe në Rambuje. Sigurisht e takova atë kur isha në Kosovë, por UÇK-ja dhe ajo çfarë po ndodhte atje ishte një rebelim kundër një regjimi autoritar dhe jo vetëm një regjim autoritar, por edhe shumë krime individuale të kryera nga serbë individualë përkundër fqinjëve të tyre shqiptarë. Dhe siç e kam shpjeguar dhe në gjykatë edhe sot kishte me shumë emocion me njerëz që kishin njohur njëri-tjetrin dhe shqiptarët u ndjen të tradhtuar nga fqinjët e tyre serbë që kishin jetuar një jetë së bashku, por sigurisht që ishin ndjesi të forta dhe këtë mendova se Hashim Thaçi bëri një punë të shkëlqyer për të ruajtur edhe popullatën e pafajshme serbe, si për ata të cilët ë që ishin mbi lumin Ibër që i shtyn shqiptarët më poshtë. Pra kam patur shqetësime për më tej, por nuk mund të thosha që Thaçi ishte dikush që të mund të dënohej për krime lufte", shtoi ai.

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator20:49

### Deputeti i LDK-së: Sonte do ta votonim Hashim Thaçin për President me 100 vota

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ermal Sadiku, ka reaguar pas aktgjykimit të sotëm të Dhomave të Specializuara në H...

KOSOVA 16 Shtator20:40

### 'Mos e lejo o Jakup Krasniqi se do jemi pishman' fjalimi epik i Rexhep Selimit kundër Gjykatës Speciale që sot i dënoi të dy me 38 vite burg

Njëmbëdhjetë vite më parë, në sallën e Kuvendit të Kosovës zhvillohej një nga debatet më të forta po...

KOSOVA 16 Shtator20:13

["Vendimi dramatik i Hagës tregoi se Kosova ka veç Shqipërinë"/ Pandeli Majko: Po përpiqen të na deformojnë historinë]

Një vendim dramatik që nuk e ndryshon historinë e ka quajtur ish-kryeministri shqiptar i Luftës së Kosovës, Pandeli Majko, verdikt...

KOSOVA 16 Shtator20:05

[Skandal në Hagë/ Specialja e përmendi si person në dijeni për krimet, Fatmir Limaj i pafajshëm nga Tribunali dhe EULEX]

Specialja e Hagës ka shpallur sot kriminel edhe një prej figurave të UÇK-së, Fatmir Limajn, megjithëse ai nuk ka akuzë. Gj...

KOSOVA 16 Shtator19:51

[Vendimi i Hagës/ Gjokutaj: Ajo gjykatë u krijuar nga antishqiptarët, dhe sigurisht që do të prodhonte antishqiptarizëm]

Gjykata Speciale për Kosovën, e ngritur pa asnjë gjyqtar shqiptar dhe me seli jashtë territorit të saj, po konsiderohet gjithnjë e...

KOSOVA 16 Shtator19:38

[“Vdekje tradhtarëve, liri çlirimtarëve”/ Pas vendimit të Hagës, protestuesit ende para Qeverisë së Kosovës]

Protestuesit po vazhdojnë të qëndrojnë para ndërtesës së Qeverisë edhe pas tri orësh prej që ishin pozicionuar...

KOSOVA 16 Shtator19:34

[Reagon sërish djali i Jakup Krasniqit: Aktgjykimi është i ndikuar nga Serbia dhe aleatët e saj]

Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, ka reaguar sërish pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve t&...

KOSOVA 16 Shtator19:23

[Vuçiç i pakënaqur me 81 vite burg ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit!]

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç reagoi pas vendimit të shkallës së Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaç...

KOSOVA 16 Shtator19:17

[Nis mbledhja e nënshkrimeve nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale]

Pesë orë pas vendimit skandaloz të Gjykatës Speciale, tashmë ka lëvizje konkrete për zhbërjen e kësaj Gjykate. Bur...

KOSOVA 16 Shtator18:54

[Vendimi i Hagës, reagon Vuçiç: Edhe pas 25 vitesh nuk jemi gati ta pranojmë çfarë ndodhi]

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...]

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi]

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...]

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.